



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:014784

Datë: 24.10.2019

Numri i dokumentit: 00601638

P.nr.385/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Qemail Suka, me bashk. profesional Feim Bytyqi, në çështjen penale të të akuzuarve A. G. dhe B. G. që të dy nga fshati L. Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar nga neni 409 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.764-7/16 të datës 16.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prani të Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro, të akuzuarve A. G. dhe B. G. si dhe të dëmtuarve F. F. dhe R. Z., me datë 24.10.2019 mori, publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

1. **A G**, nga i ati Sh dhe e ëma Xh e vajzërisë G, i lindur me dt.04.10.1984, në fshatin L Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, vozitës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
2. **B G**, nga i ati Sh dhe e ëma Xh e vajzërisë G, i lindur me dt.22.03.1976, në fshatin L Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, konduktor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 pika 1.1 të KPPK-së,

REFUZOHET AKUZA

I. Sepse i pandehuri A G:

Me datën 21.03.2016, rreth orës 08:40 min, në Stacionin e autobusëve afër shtëpisë së Kulturës në Suharekë, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, duke mos i përfillë urdhërat e tyre i kanos seriozisht, të dëmtuarit – policët F F dhe R Z, në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit ishin duke patrulluar ku edhe vërejnë se komunikacioni ishte bllokuar për shkak se i pandehuri – vozitësi i autobusit “X T” ishte duke vozitur me një shpejtësi shumë të ngadaltë, me këtë e pengonte zhvillimin normal të komunikacionit dhe e kishte bllokuar komunikacionin, me të vërejtur të dëmtuarit e ndalin të pandehurin dhe i kërkojnë dokumnetet, duke ia shqiptuar tiketën për shkak të kundërvajtjes, i pandehuri e kanos të dëmtuarin e parë me fjalët :”shihemi prapë ne”, duke vazhduar me të dëmtuarin e dytë me fjalët: “Do të gjej unë ty”.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar nga neni 409 par.1 të

KPK-së.

II. Sepse i pandehuri B G:

Me datë kohë dhe vend të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin nën I të aktgjykimit, pengon personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, të dëmtuarin – policin F F, në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit ishin duke patrulluar ku edhe vërejnë se komunikacioni ishte i bllokuar për shkak se autobusi ishte me një shpejtësi shumë të ngadaltë dhe e kishte bllokuar komunikacionin, me të vërejtur të dëmtuarit e ndalin autobusin (derisa ishin duke ia shqiptuar një tiketë të pandehurit të parë për shkak të kundërvajtjes së kryer) i pandehuri – konduktori i autobusit “X T” i pengon në punën e tyre dhe i dëmtuari e sugjeron që të shkoj në autobus, ndërsa i pandehuri duke e kanos seriozisht atë i drejtohet me fjalët: “mos um prek me dorë s’guxon mem prej ti mu”.

- Me çka kishte për të kryer veprën penale pengimi i personit zyrtar nga neni 409 par.1 të KPK-së.

Të dëmtuarit F F dhe R Z, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, kësaj Gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.764-7/16 të datës 16.05.2016, me të cilën i ka akuzuar të pandehurit për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar nga neni 409 par.1 të KPK-së, nga e cila është tërhequr në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 21.10.2019.

Meqenëse Prokurori Shtetëror ka hequr dorë nga akuza në funde të shqyrtimin gjyqësor, gjykata konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në përputhje me nenin 454 par.1 të KPPK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është i mbështetur në nenin 463 par.3 të KPPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË

P.nr.385/2016 të dt. 24.10.2019

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Qemail Suka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit - Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.